



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Deklaratë e Përbashkët për Forcimin e Procesit Zgjedhor në Kosovë

Ne, Kryetarët e Grupeve Parlamentare në Kuvendin e Republikës së Kosovës, shprehim gatishmërinë dhe zotimin për përmirësimin dhe forcimin e procesit zgjedhor, duke adresuar fillimisht çështjet e rekomanduara nga misionet e vëzhgimit të zgjedhjeve të BE-së, të nxjerra që nga viti 2013, në veçanti në zgjedhjet e përgjithshme dhe lokale të vitit 2017.

Përmirësimi dhe forcimi i procesit zgjedhor është nevojë e çdo demokracie, në veçanti e demokracive në zhvillim. Ky proces duhet të bazohet në gjetjet dhe rekomandimet e zgjedhjeve të mëparshme, dhe synon të krijojë një ambient për zgjedhje të lira, të drejta dhe transparente, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe praktikën e mira.

Kjo nismë synon të adresojë rekomandimet e nxjerra nga misionet e vëzhgimit të zgjedhjeve të BE-së dhe të përmirësojë më tej praktikën e mira zgjedhore përmes një procesi gjithëpërfshirës dhe transparent.

Angazhimi i forcave politike për përmirësimin e procesit zgjedhor nuk lidhet në asnjë formë me zgjedhjet e parakohshme apo të jashtëzakonshme që mund të ndodhin në ndërkohë.








Prandaj, dakordohemi që:

- Kuvendi i Kosovës, në pajtim me Rregulloren e Punës, të **krijojë Komisionin Parlamentar ad-hoc për përmirësimin dhe forcimin e procesit zgjedhor**, në të cilin marrin pjesë Kryetarët e Grupeve Parlamentare. Grupet e mëdha parlamentare, të cilëve ju takojnë nga dy anëtarë duhet, për aq sa është e mundur, të marrin parasysh aspektin e përfaqësimit gjinor.
- Në kuadër të **Komisionit Parlamentar ad-hoc për përmirësimin dhe forcimin e procesit zgjedhor**, të krijohet **Grupi Këshillëdhënës për përmirësimin dhe forcimin e procesit zgjedhor**, ku përfaqësohen akterët e zgjedhjeve (shoqëria civile, media, institucionet relavante dhe ato që menaxhojnë zgjedhjet, si dhe akterët ndërkombëtarë), i cili grup ofron këshilla profesionale që lidhen me forcimin e procesit zgjedhor për qëllime të vendimmarrjes nga ana e **Komisionit Parlamentar ad-hoc për përmirësimin dhe forcimin e procesit zgjedhor**.
- Kuvendi i Kosovës të ofrojë mbështetjen e nevojshme financiare dhe teknike/logjistike për **Komisionin Parlamentar ad-hoc për përmirësimin dhe forcimin e procesit zgjedhor**, si dhe për **Grupin Këshillëdhënës për përmirësimin dhe forcimin e procesit zgjedhor**.

Kërkojmë nga Kryesia e Kuvendit të iniciojë procedurën për themelimin e **Komisionit Parlamentar ad-hoc për përmirësimin dhe forcimin e procesit zgjedhor** menjëherë pas nënshkrimit të kësaj Deklarate.

Ftojme BE-në dhe OSBE-në që të mbështesin dhe ndihmojnë **Komisionin Parlamentar ad-hoc për përmirësimin dhe forcimin e procesit zgjedhor** dhe **Grupin Këshillëdhënës për përmirësimin dhe forcimin e procesit zgjedhor** me ekspertizë dhe projekte për të mundësuar arritjen e objektivave të parapara.

Nënshkruar në Prishtinë, në Kuvendin e Republikës së Kosovës, më 11 prill 2019.

Grupi Parlamentar	Emri dhe mbiemri	Nënshkrimi
LDK	Arduller Hota	
PDK	Mendi Kusumović	
Lëvizja VETËVENDOSJE!	Glauk Kosijević	
PSD	Dardan SEJDIU	
AAK	Amret Jusufi	
NISMA Socialdemokratik	Bisell Sheni	
SRPSKA LISTA	Sasa Milosavjević	
GP-G+	Albert Luedh'	